



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2021, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
"KUZHINA QENDRORE" SHA, PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për lejimin e mjeteve NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 27,255 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së Përgjithshme, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-120/03-47770/21, më 12.03.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Arsyetim

Bordi i NPL "Kuzhina Qendrore" dhe ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv, janë drejtuar me një shkresë, përmes së cilës kanë kërkuar mbështetje fillestare për nevojat e Kuzhinës Qendrore.

Ne e kemi pranuar kërkesën e tyre, në muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pas shikimit të lëndës, konsiderojmë që kjo mbështetje duhet të aprovohet.

Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës, aksionarët kanë informuar Kuvendin për procesin deri ku ka mbërritur ndërmarrja, por për arsye të transparencës dhe arsyeshmërisë së këtij vendimi, po i listojmë gjërat për të cilat janë bërë:

1. NPL "Kuzhina Qendrore" SHA, Prishtinë, është regjistruar në ARBK, me nr. të biznesit: 811479618;
2. Është hapur xhirollogaria e ndërmarrjes në Bankën Private për Biznes;
3. Është dizajnuar llogoja e re e ndërmarrjes, në koordinim nga Base Agency;
4. Janë riparuar disa mjete të punës që kanë pasur probleme teknike, si grirësja e sallatës, funksionalizimi i tërësishëm i kazanave, rregullimi i ngrohësit të ujit, servisimi i ngrohjes dhe klimatizimi;
5. Është renovuar pjesërisht pjesa e brendshme e mureve të brendshme, me rekomandim nga AVUK, përmes kërkesës që i'a kemi bërë Ndërmarrjes Publike Banesore, konkretisht z. Drilon Pireva;
6. Është siguruar zyra administrative e Kuzhinës Qendrore. Si ushtrues detyre, kam lidhur marrëveshje me Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, që të na e sigurojë përkohësisht një zyrë, ku do të kryhen të gjitha punët administrative. Nga Komuna e Prishtinës na janë siguruar tavolinat e punës dhe printeri, në ndërkohë jemi në pritje të kompjuterëve dhe karrikeve. Gjatë kësaj kohe pritet renovimi i zyrës, për arsye se është e dëmtuar tej mase.

Bordi i ka miratuar aktet si në vijim: jemi marrë me përpilimin e akteve përmes së cilave do të funksionojmë si ndërmarrje, e të cilat janë:

1. Plani i biznesit për vitin 2021;
2. Rregullorja e punës së komiteteve të Bordit të Drejtorëve të NPL Kuzhina Qendrore, SHA;
3. Rregullorja e marrëdhënies së punës dhe procedurës disiplinore në NPL "Kuzhina Qendrore", SHA;
4. Rregullorja për orarin e punës në NPL "Kuzhina Qendrore", SHA;
5. Rregullorja për arka e NPL "Kuzhina Qendrore", SHA;
6. Rregullorja mbi pafat dhe kompensimet e tjera në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA;
7. Udhëzimi mbi përshkrimin e detyrave të punës në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA;
8. Organogrami i NPL Kuzhina Qendrore, SHA.